



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 420/12 Prot.

Tiranë, më 23 /03/2017

VENDIM

Nr. 55 ,datë 23 / 3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 420 Prot., datë 06.03.2017, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik, Bashkia Elbasan (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet shkresës datë 13.02.2017, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik, kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Një kopje të kontratës mes Bashkisë Elbasan dhe kompanisë Era Travel 2013 shpk & Tirana Bus shpk për transportin e mësuesve dhe nxënësve të lidhur në Maj 2015.*
2. *Raportin e supervizimit të kontratës në zbatim të legjislacionit dhe VKM përkatës.*
3. *Prononcim të bashkisë mbi cilësinë e shërbimit të transportit të mësuesve dhe nxënësve në bashkinë Elbasan dhe veçanërisht për linjat në Paperr, Gracen, Gjinar, Labinot-fushë: Pse transportohen bashkë mësues dhe nxënës? Pse nuk ka linja transporti në disa fshatra si Gracen dhe Paperr?*

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkesit me shkresën nr. 344/1 Prot, datë 01.03.2017, duke i vendosur në dispozicion informacion të përgjithshëm mbi kërkesën e datës 13.02.2017 si dhe një formular kontrate të lidhur mes Bashkisë Elbasan dhe Shoqërive “Era Travel 2013” shpk & “Tirana Bus” shpk.

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 420 Prot., datë 06.03.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik duke kërkuar rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 15.03.2017.

Me shkresën nr. 344/2 Prot., datë 16.03.2017 Autoriteti Publik është përgjigjur duke dhënë informacion të pjesshëm dhe jo shterues lidhur me kërkesën.

Nga administrimi i provave, rezulton se informacioni mbi *kopjen e kontratës së lidhur mes Bashkisë Elbasan dhe kompanisë Era Travel 2013 shpk & Tirana Bus shpk për transportin e mësuesve dhe nxënësve* nuk është vendosur i plotë në dispozicion të kërkuesit. Konkretisht mungojnë dokumentet që duhet të jenë bashkëlidhur formularit të kontratës, ku ndër të tjera listohen Kushtet e Përgjithshme dhe ato të Veçanta të Kontratës.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës vlerëson se informacioni i kërkuar është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet.

Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Znj. _____ ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Znj. _____, Nr. 420 Prot., datë 06.03.2017, kundër Autoritetit Publik, Bashkia Elbasan, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Bashkia Elbasan, për vënien në dispozicion në mënyrë të plotë të dokumentacionit të kërkuar (*Një kopje të kontratës së lidhur mes Bashkisë Elbasan dhe kompanisë Era Travel 2013 shpk & Tirana Bus shpk për transportin e mësuesve dhe nxënësve*) brenda datës 30.03.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 23.3.2017.

